



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:066289

Datë: 26.02.2024

Numri i dokumentit: 05373363

C.nr.569/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: S.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit dhe P.Ç. nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës B.K.S. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve “P.....”, me seli në Prishtinë, me të autorizuarën V.V. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 481.20 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prani të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 12.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit P.Ç. nga Prizreni, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit P.Ç. në emër të kompensimit të dëmit material në automjetin “VW Golf 5”, me targa të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 24.02.2021 në Prizren, t’ia paguajë shumën prej 481.20 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (12.04.2021) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit P.Ç. t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 450.80 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

IV. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit me të cilën ka kërkuar që të “DETYROHET e paditura, që në emër të kompensimit të dëmit material në automjetin “VW Golf 5”, me targa të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 24.02.2021 në Prizren, t’ia paguajë shumën prej 481.20 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (12.04.2021) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm”.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi S.Ç. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës B.K.S. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve “P.....”, me seli në Prishtinë, me të autorizuarën V.V. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 481.20 euro.

Në padi ka theksuar se më datë 24.02.2021, në Prizren, ka ndodhur një aksident trafiku, ku deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të vozitësit të automjetit i cili nuk ka respektuar rregullat e komunikacionit, që në momentin e shkakimit të aksidentit nuk ka pasur të kontraktuar policën e sigurimit dhe nga ky aksident dëme materiale në automjet ka pësuar automjeti tjetër, i cili ishte duke u drejtuar nga paditësi S.Ç. tip VW Golf 5, me targa regjistrimi ngjyrë e bardhë, viti i prodhimit 2004. Në këto rrethana, përgjegjësia bie mbi të paditurën B.K.S. Baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, pasi që aksidenti ka ndodhur me lëshimet e drejtuesit të automjetit që nuk kishte mbulesë siguruese. Duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) dhe Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, paditësit i takon e drejta e kompensimit të dëmit nga e paditura. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit Salajdin Çoçaj dhe të detyrohet e paditura në kompensimin e dëmit në vlerë prej 1,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në përgjigjen në padi, e paditura ka deklaruar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, në mungesë të legjitimitetit real aktiv, pasi që paditësi S.Ç. nuk është pronar i veturës. Andaj, ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet e pabazuar.

Me parashtresën e datës 01.02.2024, i autorizuari i paditësit S.Ç. ka zgjeruar padinë në aspektin subjektiv, ashtu që si i autorizuar i paditësit P.Ç. paditësi P.Ç. t'i bashkohet paditësit S.Ç. në cilësi të bashkëndërgjyqësit në anën e palës paditëse. Gjykata me aktvendimin e marrë në procesverbalin e datës 12.02.2024, ka lejuar ndryshimin e padisë në aspektin subjektiv dhe si palë paditëse janë konstatuar: S.Ç. dhe P.Ç.

I autorizuari i paditësve, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke u bazuar se baza juridike lidhur me shkaktimin e aksidentit nuk është kontestuese, lartësinë e kërkesëpadisë e kemi vërtetuar përmes ekspertizës së makinerisë, i cili ka konstatuar se lartësia e dëmit është në shumë prej 481.20 euro. Andaj, mbi këtë bazë bëjë precizimin e kërkesëpadisë duke i propozuar gjykatës që të aprovoj padinë e paditësve si të bazuar dhe të detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit që në emër të kompensimit të dëmit material në automjetin VW Golf 5, me targa t'ia kompensojë shumën prej 481.20 euro, me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë më datë 12.04.2021 e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Po ashtu, të detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve, të autorizuarit të tyre t'ia paguajë shpenzimet që do të llogariten bazuar në tarifën e OAK-së, shpenzimet për taksë gjyqësore dhe ekspertizë të makinerisë.

Me aktvendimin procedural të marrë në procesverbalin e datës 12.02.2024, gjykata ka lejuar precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv, të bërë nga i autorizuari i paditësve.

E autorizuar e të paditurës, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, në mungesë të legjitimitetit real aktiv. Edhe pas pranimit të parashtresës së datës 01.02.2024, me të cilën është bërë ndryshimi i padisë në aspektin subjektiv, për të paditurën mbetet kontestuese baza juridike, për faktin se bazuar në nenin 258 par. 2 të LPK-së lidhur me par. 4, ku përcaktohet se për ndryshimin e padisë duhet të plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative, që paditësi pa fajin e tij nuk ka mundur më parë ta ndryshojë padinë e që në rastin konkret kjo nuk vlen, pasi që paditësi që nga fillimi i kësaj procedure ka pasur dijeni se kush është pronar dhe kush mund të jetë paditës në këtë procedurë. Andaj, ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe shpenzimet e kërkuara nga përfaqësuesi i palës paditëse.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: ekspertizën mbi vlerësimin e dëmit në mjetin motorik e datës 18.12.2023, punuar nga eksperti B.L. raportin e aksidentit numër 2021-GL-063 i datës 24.02.2021; kontratën e shitblerjes e datës 26.11.2020; vërtetimin për kontrollin e automjetit numër 029882-16P; policën e sigurimit e datës 25.12.2020; lexuesin elektronik të letërnjoftimit për paditësin P.Ç. lexuesin elektronik të letërnjoftimit për paditësin S.Ç. vërtetimin e nënshkrimit i datës 15.01.2021; autorizimin e dhënë nga paditësi P.Ç. për paditësin S.Ç. vërtetimin e nënshkrimit i datës 11.12.2020; konfirmimin për policën e sigurimit i datës 26.11.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditësit P.Ç. është e bazuar, ndërsa kërkesëpadia e paditësit S.Ç. është e pabazuar.

Nga leximi i ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit në mjetin motorik e datës 18.12.2023, punuar nga eksperti B.L. vërtetohet se riparimi i dëmit në automjetin VW Golf 5, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 24.02.2021, ka qenë teknikisht i mundur dhe ekonomikisht i arsyeshëm dhe vlera e riparimit të këtij dëmi është në lartësi prej 481.20 euro.

Nga leximi i raportit të aksidentit numër 2021-GL-063 i datës 24.02.2021, është vërtetuar se më datë 24.02.2021, në Prizren, në rrugën Transiti i vjetër, ka ndodhur një aksident i komunikacionit, ku deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të vozitësit të automjetit A, që në momentin e shkakimit të aksidentit nuk ka pasur të kontraktuar policën e sigurimit dhe nga ky aksident dëme materiale në automjet ka pësuar automjeti tjetër B, i cili ishte duke u drejtuar nga paditësi S.Ç.

Nga leximi i kontratës së shitblerjes e datës 26.11.2020, u vërtetua se personi A.K. në cilësi të shitësit, ia ka shitur paditësit P.Ç. në cilësi të shitësit, automjetin e tipit VW Golf, viti i prodhimit 2004, me çmim prej 10,000.00 dinarë.

Nga leximi i vërtetimit për kontrollin e automjetit numër 029882-16P, është vërtetuar se automjetit VW Golf i është bërë kontrolli i automjetit.

Nga leximi i policën e sigurimit e datës 25.12.2020, u vërtetua se paditësi P.Ç. ka paguar policën e sigurimit për automjetin VW Golf, viti i prodhimit 2004, për periudhën kohore nga data 28.12.2020 deri më 28.12.2021.

Nga leximi i lexuesit elektronik të letërnjoftimit për paditësin P.Ç. vërtetohen të dhënat personale për paditësin P.Ç. letërnjoftim i cili ka afat deri më datë 17.10.2023.

Nga leximi i lexuesit elektronik të letërnjoftimit për paditësin S.Ç. vërtetohen të dhënat personale për paditësin S.Ç. letërnjoftim i cili ka afat deri më datë 11.10.2023.

Nga leximi i vërtetimit të nënshkrimit i datës 15.01.2021, është vërtetuar se paditësi P.Ç. ka nënshkruar dokumentin, përkatësisht autorizimin për paditësin S.Ç.

Nga leximi i autorizimit të dhënë nga paditësi P.Ç. për paditësin S.Ç. u vërtetua se paditësi P.Ç. në cilësi të autorizuesit, ka autorizuar paditësin S.Ç. në cilësi të autorizuarit, që pa kufizime të drejtjohë automjetin VW Golf, viti i prodhimit 2004, të njëjtin ka mundur ta disponojë pa kufizim,

t'ia shes personave të tretë, ta pranojë çmimin kontraktues me rastin e shitjes së veturës dhe veprime tjera sa i përket këtij automjeti.

Nga leximi i vërtetimit të nënshkrimit i datës 11.12.2020, është vërtetuar se është vërtetuar se paditësi P.Ç. ka nënshkruar dokumentin, përkatësisht autorizimin për paditësin S.Ç.

Baza ligjore

Me nenin 136 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr.04/L-077 (LMD), është paraparë se “kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”. Pastaj, sipas nenit 140 të LMD-së shprehimisht përcaktohet që “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”. Më konkretisht, me nenin 159 par. 1 të LMD-së parashihet që “në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”.

Ndërsa sipas Ligjin nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, në nenin 10 përcaktohet që “kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”. Me nenin 18 par. 1 të këtij ligji parashihet që “personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja Kosovare e Sigurimit”.

Ndërsa, me nenin 7 par. 1 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) është paraparë se “palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Me nenin 2 par. 2 të LPK-së është paraparë se “gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në këtë drejtim, gjykata pas vlerësimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor, të propozuara nga pala paditëse dhe ajo e paditur, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit P.Ç. është e bazuar, ndërsa kërkesëpadia e paditësit S.Ç. është e pabazuar.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestuese fakti se pala paditëse ka pësuar dëm material në automjetin “VW Golf 5”, me targa në aksidentin e trafikut të datës 24.02.2021.

Kontestuese në këtë çështje juridike ishte fakti nëse pala paditëse, përkatësisht paditësi P.Ç. respektivisht S.Ç. ka legjitimitet real aktiv.

Së këndejmi, nga provat e administruara, më saktësisht nga kontrata e shitblerjes e datës 26.11.2020 dhe nga autorizimi i dhënë nga paditësi P.Ç. për paditësin S.Ç. rezulton se paditësi S.Ç. dhe P.Ç. kanë cilësinë e bashkëndërgjyqësve të thjeshtë në këtë çështje juridike kontestimore. Kështu, me nenin 264 par. 1 pika a) e LPK-së përcakton që “padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqësia) në rast se në pikëpamje të objektit të kontestit janë në bashkësi juridike apo nëse të drejtat e tyre, përkatësisht detyrimet, burojnë nga e njëjta bazë faktike apo juridike (bashkëndërgjyqësia materiale)”. Ndërsa, me nenin 264 par. 2 të LPK-së parashihet që “deri në përfundimin e seancës përgatitore, përkatësisht të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare, paditësit mund

t'i bashkohet, nën kushtet e paragrafit 1 të këtij neni, edhe një paditës tjetër apo të zgjerohet padia edhe në një të paditur tjetër, duke u marrë pëlqimi i këtij". Në fund, në paragrafin 3 të nenit 264 të LPK-së thuhet se "personi që i bashkohet paditësit, përkatësisht personi në të cilin zgjerohet padia duhet ta pranoj procedurën në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur ai hyn në të".

Pra, automjeti "VW Golf 5", me targa lidhur me të cilin objekt është zbatuar procedura kontestimore, është në pronësi të paditësit P.Ç. ndërsa në momentin e shkakut të aksidentit të datës 24.02.2021, është drejtuar nga paditësi S.Ç. Kështu, nga autorizimi i dhënë nga paditësi P.Ç. për paditësin S.Ç. rrjedh se paditësi P.Ç. ka autorizuar paditësin S.Ç. që me automjetin "VW Golf 5", me targa mund të disponoj, t'ia shes personave të tretë, mund t'ia dhurojë personave të tretë, mund të lejojë bartjen e të drejtës së pronësisë në blerësin dhe t'i kryejë të gjitha veprimet juridike dhe faktike me qëllim të bartjes së të drejtës së pronësisë. Andaj, gjykata ka gjetur se lidhur me objektin e kontestit, përkatësisht automjetin "VW Golf 5", me targa janë në një bashkësi juridike e faktike, përkatësisht për shkak të rastit të ndodhur (aksidentit të trafikut të datës 24.02.2021), paditësit gjenden në bashkësinë e njëjtë juridike, për shkak të objektit të kontestit. Në këtë drejtim, gjykata pasi që ka marrë pëlqimin e paditësit P.Ç. në përputhje me nenin 264 par. 2 dhe 3 lidhur me paragrafin 1 të këtij neni të LPK-së, ka lejuar që në anën e palës paditëse të bashkohet edhe paditësi P.Ç.

Mbi këto bazë, provohet se është e bazuar baza juridike e kërkesëpadisë dhe detyrimi i të paditurës B.K.S. për kompensimin e dëmit material për paditësin P.Ç. në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia lidhur me nenin 140 dhe 159 të LMD-së.

Për të vërtetuar saktë vlerën e dëmit material të pësuar nga pala paditëse, gjykata ka angazhuar ekspertin e makinerisë, i cili përmes ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit në mjetin motorik e datës 18.12.2023, eksperti B.L. ka vlerësuar se dëmi është në lartësi prej 481.20 euro, të cilës ekspertizë gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që e njëjta është punuar në mënyrë objektive dhe profesionale. Në lidhje me lartësinë e aprovuar, gjykata vlerëson se e njëjta është adekuate, e drejtë dhe në përputhje me dëmin, përkatësisht një shumë e tillë e kompensimit të dëmit material bazohet në ekspertizën e makinerisë së datës 18.12.2023 të ekspertit B.L. e cila në mënyrë profesionale dhe të drejtë ka përcaktuar e pasqyruar dëmin material që paditësi, përkatësisht vetura e tij e ka pësuar në aksidentin e datës 24.02.2021 dhe në ekspertizën e lartcekur, vërejtje nuk kishte as pala e paditur.

Në anën tjetër, gjykata ka vlerësuar deklarinimin e të autorizuarës së të paditurës që përkundër të gjithave, mbetet kontestuese baza juridike, në mungesë të legjitimitetit real aktiv dhe se nuk janë plotësuar kushtet për ndryshimin e padisë në përputhje me nenin 258 të LPK-së, mirëpo erdhi në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe nuk qëndron. Më konkretisht, gjykata ka lejuar zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv duke u bazuar në nenin 264 të LPK-së, pasi që ka vlerësuar se në këtë rast janë paditësit: S.Ç. dhe P.Ç. janë bashkëndërgjyqës dhe kësaj janë përmbushur kushtet për të lejuar bashkimin e paditësit P.Ç. në anën e palës paditëse. Andaj, pretendimi i palës së paditur dhe orientimi i saj në mos përmbushjen e kushteve për ndryshimin e padisë sipas nenit 258 të LPK-së, nuk kishte justifikim dhe mbështetje juridike.

Për arsyet e dhëna më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe e detyroi të paditurën, që në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në automjetin e paditësit P.Ç. si pasojë e aksidentit të trafikut, t'ia paguaj shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Si rrjedhojë, bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura, gjykata konsideron se shuma e aprovuar si në dispozitivin të këtij aktgjykimi është adekuate, reale dhe e drejtë, duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar automjetit të paditësit, si dhe do t'i mundësojë të njëjtit që me këtë shumë ta riparojë në tërësi automjetin e tij dhe ta kthejë në gjendjen e mëparshme.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën për dëmin material nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (12.04.2021), dhe në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vendosi sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjyqimit, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit S.Ç. për faktin se e njëjta nuk ishte e bazuar në prova dhe dispozita ligjore. Më saktësisht, përkundër faktit se paditësi S.Ç. kishte autorizim nga paditësi P.Ç. që me automjetin “VW Golf 5”, me targa mund të disponoj dhe t’i ndërmer veprimet tjera, në këtë autorizim nuk kishte një të drejtë shprehimore ku do të theksohej se ai mund të kërkoj kompensimin e dëmit nga aksidenti i trafikut, përkatësisht automjeti në fjalë nuk ishte në pronësi të paditësit S.Ç. Më konkretisht, të drejtat dhe detyrimet e pronarit të mjetit motorik gjatë periudhës së policës së sigurimit, që rrjedhin nga kontrata e sigurimit, i takojnë vetëm pronarit të mjetit motorik, në këtë rast paditësit P.Ç.

Gjykata ka bërë vlerësimin edhe të provave tjera të administruara dhe të përmendura më lartë, por vlerësoi se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore ndryshe të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, është marrë konform nenit 449 dhe 452 par.1 lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së lidhur me Tarifën e OAK-së, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit P.Ç. t’ia kompensoj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 78.00 Euro, për përfaqësim në 2 (dy) seanca gjyqësore shumën me nga 101.40 euro, në emër të ekspertizës së makinerisë shumën prej 150.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 450.80 euro.

Nga faktet dhe arsyet e cekura më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me dispozitat ligjore të theksuara në arsyetim të aktgjyqimit dhe nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.569/2021 më datë 12.02.2024

Gjyqtari,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.